



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr 138 Prot

Tiranë, më 19, 1.2017

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2016.

Drejtuar: **Znj. Gelardina PRODANI**
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCEVE

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit, për vitin 2016, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar si dhe parandalimit dhe goditjes së korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjes së individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit nga hakmarrja në përputhje me Ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.147/2015, datë 17.12.2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimit nr.1, datë 15.1.2016, « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016 », shkresave të Ministrisë së Financave nr.17761/246 prot, datë 25.1.2016 “Dërgohet miratimi i detajimit të investimeve për vitin 2016”, nr.10739/55 prot, datë 12.8.2016 “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve të buxhetit të vitit 2016, për shpenzime korrente”, nr.10739/46 prot, datë 11.8.2016, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.1, datë 29.7.2016”, dhe shkresës nr.17366/41 prot, datë 23.12.2016 “Dërgohet miratimi i detajimit të ndryshimeve të buxhetit të vitit 2016, për shpenzime korrente” në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 15.12.2016, “Për disa ndryshime në Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, i është akorduar një fond buxhetor prej 129 milionë e 125 mijë e 120 lekë, i cili përbëhet nga:
Fondi i Pagave 82 milion e 290 mijë lekë (zëri 600),
Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 11 milion e 110 mijë lekë (zëri 601),
Fondi për Shpenzime Operative: 18 milion e 910 mijë lekë (zëri 602),
Fondi për Investime: 16 milion lekë (zëri 231),
Transferime korrente: 277.6 mijë lekë (zëri 604),
Transferime për financime të tjera: 537.52 mijë lekë (zëri 606).

Buxheti për vitin 2016, është akorduar për programin “Menaxhim, Administrim, Planifikim” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2016-2018. Referuar buxhetit të vitit 2016, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të hetimit administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe parandalimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrtarëve të tjerë si dhe

ILDKPKI, në mbështetje të burimeve financiare të vitit 2016, ka realizuar objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, me qëllim realizimin e misionit të ILDKPKI, në përputhje me objektivat prioritare të institucionit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.1, datë 15.1.2016, « *Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016* », për periudhën e raportuar Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore 121,379,338.3 lekë ose 94%, të fondit të planifikuar për vitin 2016.

Llog. Ek	Peshkrimi	Plan Buxheti vjetor 2016	Plan Buxheti vjetor 2016 I Rishikuar	Buxheti I realizuar Viti 2016	Realizimi % si 12-Mujor
600	Fond Page	79,000	82,290,000	78,744,999.0	95.69%
601	Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore	9,000	11,110,000	10,857,220.0	97.72%
602	Shpenzime operative	25,760	18,910,000	15,646,030.30	82.74%
604	Transferata korrente te brendshme		277,600	235,960.0	85.00%
606	Transferime per financime të tjera	240	537,520	537,520.0	100.00%
231	Investime	4,000	16,000,000	15,357,609.00	95.99%
	Totali	118,000	129,125,120	121,379,338.3	94.00%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri mesatar i punonjësve është realizuar 62.6 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.48, datë 22.7.2016. “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar*”.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 78,744,999 lekë ose 95.69% e fondit të planifikuar për vitin 2016 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 10,857,220 lekë ose 97.72%, e planifikimit për periudhën respektive.

Mosrealizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, ka ardhur si rezultat i ndryshimit në rritje me 10 punonjës të numrit të përgjithshëm të punonjësve sipas vendimit të sipërcituar, me rritjen e kompetencave të ILDKPKI, për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat si dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë veprimet korruptive në vendin e tyre të punës në përputhje me Ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016, “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

ILDKPKI, gjatë kësaj periudhe ka kryer procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve të reja të punës sipas kategorive përkatëse të miratuara, në zbatim të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin Civil*” i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij.

Fondi për shpenzime në zerin investime (zeri 231)

Vlera e përgjithshme e planit të fondit të investimeve të rishikuar për vitin 2016, në zbatim të shkresës nr. 10739/77 prot, datë 17.8.2016, “*Miratim limiti*” të Ministrisë së Financave, është 16 milion lekë. Për vitin 2016, është prokuruar vlera prej 15,850,000 lekë, ose 99.06% e

fondit të planifikuar dhe realizuar në vlerën 15,357,609 lekë ose 95.99% e fondit të planifikuar.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2016, të ndryshuar, për këtë zë shpenzimi ka realizuar fondet e planifikuara për fondet e investimeve të vëna në dispozicion si më poshtë;

- 1) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është realizuar në vlerën 1,436,882 lekë me tvsh, fituar nga firma “CCS” shpk, me procedurën kërkesë për propozim. Likujdimi është kryer sipas kushteve teknike në kontratën dypalëshe lidhur më datë 8.04.2016.
- 2) Fondi i investimeve me objekt “*Sistem Kamera Survejimi*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar në vlerën 2,250,000 lekë me tvsh, fituar nga firma “Synapse ATS” shpk, me procedurën kërkesë për propozim në vlerën 2,160,000 lekë, ose 96 % e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në mbështetje të kontratës dypalëshe, datë 23.06.2016.
- 3) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje kondicionerë*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 118,800 lekë, është realizuar me procedurën blerje me vlerë të vogël, në vlerën 117,600 lekë me tvsh, ose 98.9 % e fondit të planifikuar sipas specifikimeve teknike në ofertë.
- 4) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje Pajisje*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 44,318 lekë, është realizuar me procedurën blerje me vlerë të vogël, në vlerën 42,408 lekë me tvsh, ose 95.7 % e fondit të planifikuar dhe është likjuar plotësisht.
- 5) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje autoveturë*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në fonde shtesë me Aktin Normativ nr.1 datë 29.07.2016, “*Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, “Për buxhtin e vitit 2016”*”, është prokuruar në vlerën 10,000,000 lekë me tvsh dhe fituar nga shoqëria private “Auto Star Albania” Sh.a me procedurën tender i hapur, në vlerën 9.8 milion lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në zbatim të kushteve të kontratës të lidhur ndërmjet palëve datë 4.10.2016.
- 6) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në fonde shtesë me Aktin Normativ nr.1 datë 29.07.2016, “*Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, “Për buxhtin e vitit 2016”*” dhe prokuruar me procedurën kërkesë me propozim në vlerën 1,134,000 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer firmës fituese “Atom” shpk në zbatim të kushteve të kontratës të lidhur ndërmjet palëve datë 16.9.2016, në vlerën 1,019,520 lekë.
- 7) Fondi i investimeve me objekt “*Blerje pajisje dhe orendi zyre*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në fonde shtesë me Aktin Normativ nr.1 datë 29.07.2016, “*Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, “Për buxhtin e vitit 2016”*”, është prokuruar në vlerën 866,000 lekë me tvsh, fituar nga firma private “RO-AL” shpk, me procedurën blerje e vogël dhe likjuar në vlerën 781,199 lekë, në plotësim të kushteve dhe specifikimeve teknike në ofertë.
- 8) Fondi i investimeve me objekt “*Faqe Web*”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 150 mijë lekë nuk është realizuar, kjo me arsye se gjatë vitit 2017 e në vazhdim, ILDKPKI në mbështetje të rekomandimeve të dhëna nga Bashkimi Evropian, do të programojë dhe realizojë projektin “*Deklarimi Online*” të deklaratës së pasurisë. Ky projekt kërkon një faqe web teknikisht më të avancuar dhe si rrjedhojë përdorimi i këtij fondi nuk do të ishte eficient.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602),

Për vitin 2016, për këtë zë të shpenzimeve, është realizuar gjithsej vlera prej 15,646,030.3 lekë ose 82.74% e fondit të planifikuar duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi .

Për periudhën respektive, realizimi i shpenzimeve në këtë zë të planifikimit buxhetor, është mbështetur në realizimin e kërkesave të cilat lidhen me;

- Në realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike, në funksion të veprimtarisë të institucionit.
- Realizimin e shpenzimeve për blerje materiale e shërbime sipas nevojave konkrete, për krijimin e kushteve të një aktiviteti normal institucional.
- Verifikimin dhe hetimin administrativ të interesave private të zyrtarëve brenda vendit.
- Forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile, medias dhe publikut të gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave private pasurore, si dhe për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave dhe abuzimin me pushtetin për shkak të përfitimeve jo ligjore për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta.

Për këtë periudhë të vitit 2016, ILDKPKI, në mbështetje të Regjistrisë të Parashikimeve për Prokurimet Publike, ka realizuar shpenzime nëpërmjet prokurimit me tender me procedurën kërkesë për propozim, sipas objekteve më poshtë;

- 1) Fondi me objekt “*Shërbim me roje civile*”, prokurimi i të cilit është realizuar 79.52 % e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Myrto Security” Shpk, në vlerën 2,385,668 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer cdo muaj, sipas kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 6.4.2016.
- 2) Fondi me objekt “*Blerje Kancelari*”, prokurimi i të cilit është realizuar 69.5 % e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Infosoft Office” shpk dhe likujduar plotësisht në vlerën 1,118,341 lekë me tvsh.
- 3) Fondi me objekt “*Blerje tonera për printer dhe fotokopje*”, prokurimi i të cilit është realizuar 92 % e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti private “Addon” shpk në vlerën 1,840,901 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në mbështetje të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 13.6.2016.
- 4) Fondi me objekt “*Mirëmbajtje dhe riparime, pjesë këmbimi për automjete*”, është prokuruar me procedurën blerje me vlerë të vogël dhe është fituar nga firma private “Kombinat Servis” shpk, në vlerën 597,000 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në mbështetje të kërkesave të ILDKPKI dhe kushteve të kontrates së lidhur ndërmjet palëve, datë 20.6.2016, në mbështetje të dispozitave në fuqi.
- 5) Fondi me objekt “*Blerje karburant*” për automjetet të ILDKPKI, është prokuruar me procedurën e kërkesës për propozim, dhe është fituar nga firma private, “A & T” sha, në vlerën 900,000 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në mbështetje të kërkesave të ILDKPKI dhe kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 6.7.2016, dhe dispozitave në fuqi.

Gjatë këtij viti shpenzimet në zërin shërbime të ndryshme, janë realizuar me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike dhe lidhur kontrata të tilla si shpenzimi i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet dhe ndërtesën e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, gjeneratori e tj. të cilat institucioni ynë i ka likujduar në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marëveshjet dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim si blerje materiale dhe shërbime të ndryshme, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Realizimi i të ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, nga zyrtarë subjekt të ligjit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, të institucioneve të ndryshme, të cilat për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2016, janë 120 raste, në vlerën 14,964,000 lekë.

- 2) Zyrat Përmbartimore të rretheve për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, për gjambat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore nga zyrtarë subjekt të ligjit.
Për vitin 2016, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 91 raste, në vlerën 12,330,000 lekë, nga të cilat 71 raste në vlerën 9,930,000 lekë, kanë kaluar në llogari të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI, i 20 rasteve të tjera të cilat përbëjnë vlerën 2,400,000 lekë, është në proces likuidimi.
- 3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 31,320 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për vitin 2016, janë në vlerën 24,925,320 lekë.

Të gjitha të ardhurat, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, referuar fondit të planifikuar buxhetor të vitit 2016, të miratuar sipas projekteve dhe Regjistrin të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, ka zbatuar me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtarëve, si dhe legjislacionin financiar, nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Kozeta NDOI

